

Republika e Kosovës -Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada – Government



Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - Ministarstvo Finansija, Rada
i Transfera – Ministry of Finance, Labour and Transfers

Dogana e Kosovës – Carina Kosova – Kosovo Customs



NJOFTIM PËR INTERVISTËN ME GOJË

për oficer doganor



Gusht 2024

Dogana e Kosovës – Carina Kosova – Kosovo Customs

Bazuar në Kodin Nr. 08/L-247, Doganor dhe Akcizave të Kosovës, Neni 18 dhe nenit 22 paragrafi 1 të Udhëzimit Administrativ Nr.37/2016 për rregullimin e marrëdhënies së punës në së oficerëve doganor, dhe Neni 11 paragrafi 3 të Udhëzimit Administrativ 60/2019 për plotësim ndryshim të UA 37/2016, Dogana e Kosovës, bënë këtë:

NJOFTIM PËR MBAJTJEN E INTERVISËS ME GOJË

Kandidatët të cilët i kanë plotësuar kriteret e Konkursit të jashtëm me nr. 05.3/232/07.03.2024 për oficer doganor, ftohen që t'i nënshtrohen procesit të intervistës me gojë që do të zhvillohet gjatë muajit shtator respektivisht duke filluar nga data 02 shtator deri me 19 shtator (sipas orarit të përcaktuar në listat e publikuara), i cili proces do të mbahet në objektin e Drejtorisë së Doganës, Lagjja Kalabri, Rr. Rexhep Krasniqi në Prishtinë. Në listat e publikuar gjithashtu gjeni informacionin e saktë lidhur me kohën dhe datën e mbajtjes së intervistës.



Kërkesat para mbajtjes së intervistës me gojë

Kandidatët nga lista e publikuar duhet të paraqiten në vendin ku është paraparë mbajtja e intervistës me gojë së paku 30 minuta (gjysmë ore) para fillimit të intervistës me gojë.

Kandidatët ditën e mbajtjes së intervistës me gojë duhet të kenë me vete dokumentacionin si në vijim:

- Numrin e aplikacionit (shih në listat e shpallura), dhe
- Letërnjoftimin



Intervista me gojë

Qëllimi i intervistës me gojë është të vlerësojë kandidatin, aftësitë dhe shkathhtësitë e tij profesionale, aftësitë për të analizuar dhe për të reaguar në mënyrën e duhur në kushtet e një stresi minimal ose tjetër, vendimmarrjen, motivimin dhe përshtatshmërinë e kandidatit për t'u bërë oficer doganor.

Intervista me gojë konsiderohet e suksesshme, nëse kandidati ka kaluar pragun prej 50% të totalit të pikëve/përqindjes nga intervista. Kandidati i cili nuk e arrin këtë prag, diskualifikohet nga procesi.

Dogana e Kosovës – Carina Kosova – Kosovo Customs



Rezultati i përgjithshëm

Rezultati i përgjithshëm përcaktohet nga shuma totale e rezultatit të testit me shkrim, që do të ketë vlerë 50% dhe rezultatit të intervistës me gojë 50%.

Lista me kandidatët e përzgjedhur sipas meritës nga i gjithë procesi rekrutues, shpallet sa më parë që është e mundur dhe jo më vonë se 5 ditë pune nga përfundimi i procesit të intervistës me gojë.

Fakti që ju keni arritur këtë fazë të përzgjedhjes është dëshmi e arritjes suaj. Dogana e Kosovës ju siguron se ka ndërmarr të gjitha veprimet e nevojshme lidhur me procesin e intervistës me gojë në mënyrë që procesi të jetë me përmbajtje cilësore dhe t'i shërbejë meritokracisë.

Informimi i kandidatëve lidhur me rezultatin e përgjithshëm do të publikohet në ueb faqen zyrtare të Doganës së Kosovës: <https://dogana.rks-gov.net>.

Ju dëshirojmë sukses!